

**STANDARDE**



**PËR ARSIM**

**INTERKULTUROR**

në arsimin fillor



Бр. Nr. 12-11647/2  
06-08-2021 20 год. vit  
СКОПЈЕ - ШКУП

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр.96/19 и 110/19), и Мерка А3.2.1.1 „Изготвување на стандарди за интеркултурализам за секој период од основното образование“ од Акцискиот план составен дел на Стратегијата за развој на концептот за едно општество и интеркултурализам, по доставен предлог од Бирото за развој на образованието, министерот за образование и наука донесе,

### РЕШЕНИЕ

за донесување на Стандарди за интеркултурно образование

1. Со ова Решение се донесуваат Стандарди за интеркултурно образование.
2. Составен дел на ова Решение се Стандардите за интеркултурно образование.
3. Ова Решение влегува во сила со денот на неговото донесување.

### ОБРАЗЛОЖЕНИЕ

Согласно мерка А3.2.1.1 „Изготвување на стандарди за интеркултурализам за секој период од основното образование“ од Акцискиот план составен дел на Стратегијата за развој на концептот за едно општество и интеркултурализам, по доставен предлог од Бирото за развој на образованието, бр. 08-1215/1 од 28.7.2021 година, министерот за образование и наука ги донесе Стандардите за интеркултурно образование.

Согласно наведеното се одлучи како во диспозитивот на ова решение.

Министерка,  
Мила Царовска



Доставено до:

- Биро за развој на образованието;
- Сектор за основно образование,
- архива.

Изготвиле: Билјана Трајковска   
Назихтере Сулејмани 

Ky dokument është përpiluar nga grupi punues i përfaqësuesve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra e Arsimit Profesional dhe Trajnimit, Forumi Rinor Arsimor, mësimdhënës dhe profesorë universitarë. Aktivitetet për përpilimin e përmbajtjes së dokumentit janë realizuar në kuadër të projektit “Forcim të bashkëpunimit multi-etnik në komunat” të mbështetur nga Fondacioni për fëmijë Pestaloci dhe “Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsim”, të zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë e Zhvillimit të Arsimit. Përmbajtja e dokumentit u përket autorëve dhe nuk i shprehë qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

#### **Anëtarë të grupit punues për përpilimin e dokumentit**

1. Ajshe Ajrullai
2. Mr. Gorica Mickovska
3. Nazihtere Sulejmani
4. Antonella Stojanoska
5. Mr. Ardijana Isahi Palloshi
6. Prof. dr. Trajçe Stojanov
7. Prof. dr. Maja Muhiq
8. Mr. Anita Angellovska
9. Dejan Rizinski

#### **Bashkëpunëtorë të cilët morën pjesë në përpilimin e dokumentit**

Besnik Ramadani, Tulaha Tahir, Besa Reçi, Ana Mickovska Raleva

#### **Redaksia profesionale**

Mr. Mitko Çeshllarov

# PËRMBAJTJA

I	HYRJE: POZICIONE FILLESTARE	6
II	DOKUMENTET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE SI BAZË	7
III	PËRKUFIZIMI I KATEGORIVE THEMELORE	10
IV	PARIME TË PËRGJITHSHME	12
V	PËRCAKTIM I STANDARDEVE	15
VI	LIDHSHMËRI ME STANDARDET KOMBËTARE	17
VII	STANDARDE PËR ARSIM INTERKULTUROR	23
VIII	ZHVILLIM I KOMPETENCAVE INTERKULTURORE	68
IX	METODA TË REKOMANDUARA PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE INTERKULTURORE	70

# HYRJE: POZICIONE FILLESTARE

Zhvillimi i standardeve dhe kompetencave në arsim është një nga qëllimet, por edhe themelet e çdo sistemi arsimor. Pa zhvillim të standardeve arsimore, është i pamundshëm vizioni i BE-së për një “zonë arsimore evropiane”, përmes të cilës do të mund të shfrytëzohë gjithë potencialin e arsimit dhe kulturës në shtetet evropiane, përmes hapjes së vendeve të punës, drejtësisë sociale dhe qytetarisë aktive. Arsimi në këtë mënyrë bëhet mundësi për të ndërtuar, por edhe për të përjetuar identitetin evropian në të gjithë diversitetin e tij. Për këto arsye, në vitin 2006, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian miratuan *Rekomandimin për kompetencat kyçe për nxënie të përjetshme* (të rishikuar dhe plotësuar disa herë, deri në vitin 2018)<sup>1</sup>.

Me këtë *Rekomandim*, pritet që vendet anëtare „të sigurojnë zhvillimin e kompetencave kyçe për të gjithë, si pjesë e strategjive të tyre për nxënie të përjetshme, duke përfshirë edhe strategjitë për arritjen e arsimimit universal, si dhe t'i shfrytëzojnë kompetencat kyçe për nxënie të përjetshme – korniza referente evropiane“. Që nga miratimi i tij, *Rekomandimi* bëhet dokumenti kryesor referues në vendet e Evropës për zhvillimin e arsimit, i orientuar drejt kompetencave. Në këtë dokument të rëndësishëm evropian për arsimin, janë përkufizuar gjithsej 8 (tetë) kompetenca, esenciale për qytetarët, për zhvillimin e tyre personal, për stil të shëndoshë dhe të qëndrueshëm, punësim, qytetari aktive dhe inkluzion social”. Në mënyrë evidente, qytetaria aktive dhe inkluzioni janë një nga vlerat themelore të BE-së. Si rrjedhojë, aspekti i multikulturës dhe integrimi interkulturore, paraqet prioritet qendror për BE-në. Këto vlera, të rëndësishme në këtë rast edhe për ne, mund të jenë të përfshira me atë që në këtë dokument është përkufizuar në grupin e gjashtë ose të tetë të kompetencave, respektivisht *Kompetencat shoqërore dhe qytetare* dhe *Kompetencat për vetëdije kulturore dhe ekspresion kulturor*.

Nga kjo, është e qartë se shtetet evropiane rekomandojnë sistem arsimor me standarde të përpiluara në mënyrë të saktë për vëzhgimin e implementimit të këtyre kompetencave të rëndësishme në atë hapësirë të përbashkët arsimore evropiane.

---

1 Recommendations (2018/C 189/01). [[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uris-erv:OJ.C\\_.2018.189.01.0001.01.ENG&toc=OJ.C:2018:189:TOC](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uris-erv:OJ.C_.2018.189.01.0001.01.ENG&toc=OJ.C:2018:189:TOC)]

# DOKUMENTET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE SI BAZË

Standardet e propozuara interkulturore do të mbështeten në disa dokumente vendore, kombëtare, por edhe në disa ndërkombëtare.

**Dokumentet kombëtare** si vijon, në të cilat idetë për multikulturalizmin dhe integrimin ndëretnik dhe interkulturore janë përfshirë si vlera, vizione dhe qëllime, shërbenin si bazë fillestare në përpilimin e këtyre standardeve:



*Strategjia për arsimin dhe plan veprimi 2018-2025;*



Strategjia kombëtare me plan veprimi për shoqëri dhe interkulturalizëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;



*Koncepcioni i arsimit fillor;*



*Standarde kombëtare për arsim fillor, që i përkufizojnë kompetencat kyçe në fund të arsimit fillor;*



*Treguesit për cilësinë e punës së shkollave;*



*Doracaku për vlerësim integral, që paraqet kornizën metodologjike për matjen e cilësisë së procesit arsimor.*

Baza e përpilimit të këtij dokument ishin të gjitha përvojat, praktikat dhe dokumentet e mira të deritanishme, nga Projekti *Forcimi i bashkëpunimit multietnik në komunat, i mbështetur nga Fondacioni për fëmijë Pestaloci, Projekti për Integrim Ndëretnik në Arsim (PINA) dhe Projekti për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsim (INRA) i mbështetur nga USAID-i.*

**Dokumentet ndërkombëtare**, që janë përdorur si orientues themelorë ishin:

*European Reference Framework of Key Competences for Lifelong Learning* (Korniza evropiane për kompetencat kyçe për nxënie të përjetshme), që ishte baza pedagogjike, formale e standardeve, derisa në aspektin e përmbajtjes i referohen:



*UNESCO Guidelines on Intercultural Education*<sup>2</sup> (Udhëzime të UNESCO-s për arsim interkulturore), që në fakt paraqet, „instrumentin për vendosjen e standardeve, rezultat i hulumtimeve dhe konferencave të shumta, veçanërisht nga takimi i ekspertëve i mbajtur në UNESCO, mars 2006“<sup>3</sup>, që mund të shërbejë si udhëzues për ndërtimin e politikave në këtë fushë;



*UNESCO Intercultural Competences: Conceptual and Operational Framework*<sup>4</sup> (UNESCO kompetenca interkulturore: Kornizë konceptuale dhe realizuese) ku janë paraqitur konceptet themelore, terme nga fusha e interkulturalizmit dhe kompetencave interkulturore dhe të cilat paraqitnin bazën në përkufizimin e termeve themelore në dokumentin tonë;



*Intercultural competence for all: Preparation for living in a heterogeneous world*<sup>5</sup> (Kompetenca interkulturore për të gjithë: Përgatitje për jetë në botë heterogjene) ku ofrohet pasqyrë e detajuar teorike dhe praktike në “zhvillimin e kompetencave interkulturore si element kyç në arsimin mejnstrim;“<sup>6</sup>

---

2 <https://unesdocunesco.org/ark:/48223/pf0000147878>>

3 <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000147878>>, faq.7

4 <https://en.unesco.org/interculturaldialogue/resources/132>>

5 [https://www.coe.int/t/dg4/education/pestalozzi/Source/Documentation/Pestalozzi2\\_EN.pdf](https://www.coe.int/t/dg4/education/pestalozzi/Source/Documentation/Pestalozzi2_EN.pdf)>

6 **Intercultural competence for all: Preparation for living in a heterogeneous world**, Council of Europe Pestalozzi Series, No2., Council of Europe Publishing, 2012, стр., 6



---

→ OSBE: Udhëzime nga Lubjana për integrimin e shoqërive të ndryshme<sup>7</sup> prej ku buron themeli për integrimin si qëllim kyç i minoriteteve në shoqëritë multietnike;

---

→ *Reference Framework of Competences for Democratic Culture*<sup>8</sup> (Kornizë referente e kompetencave për kulturë demokratike<sup>9</sup>), që paraqet udhërrëfyesin sistematik për arsim demokratik, që nga edukimi parashkollor e deri te arsimit të lartë;

---

→ Edhe publikime, hulumtime dhe praktika të tjera të mira, referuese ndërkombëtare.

---



---

<sup>7</sup> Organization for Security and Co-operation in Europe, 2012 <<https://www.osce.org/mk/hcnm/100449>>

<sup>8</sup> **Reference Framework of Competences for Democratic Culture, Vol.1-3**, Council of Europe <<https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/rfcdc-volumes>>

<sup>9</sup> [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/11/Referentna\\_ramka-Kompetencii\\_za\\_Demokratska\\_kultura-kniga\\_3.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2019/11/Referentna_ramka-Kompetencii_za_Demokratska_kultura-kniga_3.pdf)>

# PËRKUFIZIMI I KATEGORIVE THEMELORE

Në vazhdim janë dhënë përkufizime dhe sqarime të kategorive themelore, në dispozitat e të cilave bazohemi në këtë dokument:

**Kultura** është përmbledhje e veçorive karakteristike shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale në një shoqëri ose grup shoqëror, duke përmbledhur të gjitha mënyrat për të qenë në atë shoqëri, përfshirë artin dhe letërsinë, mënyrën e jetës, mënyrën e bashkëjetesës, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet.<sup>10</sup>

**Identiteti** ka të bëjë me ndjenjën personale të njeriut për atë se kush është, ku përket dhe si identifikon veten. Shumica e individëve kanë spektër të identiteteve të ndryshme me të cilat njëjtësohen, si personalisht, ashtu edhe në aspektin shoqëror. Identitetet personale janë ato të bazuara në attribute personale (tolerant, ekstravagant, i ri, i moshuar, i kujdesshëm...) relacione interpersonale (baba, kolegë, bashkëshort...) narrative autobiografike (nga familja punëtore, me arsim të lartë...). Derisa identiteti shoqëror bazohet në anëtarësinë, përkatësinë në grupe të caktuara sociale, shoqërore (etnos, komb, religjion, gjini, racë, profesion, hobi, sport...).

**Identiteti kulturor** ka të bëjë me ato aspekte të identitetit që janë ndarë nga pjesëtarët e një kulture të përbashkët dhe sipas të cilave ata dallojnë nga ndonjë kulturë tjetër. Identiteti kulturor është i konstruktuar në aspektin shoqëror, ndërsa individët kanë identitete të shumëfishta që ndryshojnë me kalimin e kohës.

**Multikulturalizëm**, Termi multikulturalizëm e përshkruan diversitetin kulturor të shoqërisë njerëzore. Ai ka të bëjë jo vetëm me elementet e kulturës etnike dhe kombëtare por e përfshin edhe diversitetin gjuhësor, religjioz, kulturor dhe socio-ekonomik<sup>11</sup>. Edhe më saktë, në një dokument të UNESCO-s ai është përkufizuar si "bashkëveprim i kulturave të llojllojshme dhe mundësi për gjenerim të përvojave të ndara kulturore përmes dialogut dhe respektit të ndërsjellë".<sup>12</sup>

---

10 UNESCO. (1982). *Mexico City declaration on cultural policies*. Paris: UNESCO. <[http://portal.unesco.org/culture/en/fi/les/12762/11295421661mexico\\_en.pdf/mexico\\_en.pdf](http://portal.unesco.org/culture/en/fi/les/12762/11295421661mexico_en.pdf/mexico_en.pdf)>

11 UNESCO Guidelines on Intercultural Education, Paris, 2006, 17

12 UNESCO Convention on the Protection and Promotion of the Diversity of Cultural Expressions(2005), Article 8

**Interkulturalizmi** ka të bëjë me bashkëveprimin e drejtpërdrejt ose të ndërmjetësuar të dy ose më shumë grupeve të ndryshme kulturore të çfarëdo madhësie, në çfarëdo niveli të komunikimit të tyre dhe ndikimit të ndërsjellë. Interkulturalizmi është në kuptim të caktuar reaksion i multikulturalizmit dhe kritika e tij si model që nuk garanton bashkëveprim mes kulturave të ndryshme dhe bashkëveprim të suksesshëm të pjesëtarëve të tyre në shoqërinë multietnike, ndërsa legjitimon ndarjen e bashkësive. Përballë kësaj, interkulturalizmi e promovon konceptin e shkëmbimit dinamik kulturor, dialogut dhe bashkëveprimit mes kulturave.

**Integrimi interkulturore** në përputhje me përkufizimin e dhënë për interkulturalizmin, nënkupton qasje të barabartë dhe trajtim të kulturave të ndryshme (mund të ndërlidhet edhe me gjininë e ndryshme, orientimin seksual, racën, statusin social) në të gjitha domenet shoqërore mes të cilave arsimit, puna, shëndetësia, etj.

**Arsimi interkulturore** – koncepti i arsimit interkulturore është i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave interkulturore, ndërsa ka të bëjë me aftësimin e nxënësve për të kuptuar dhe praktikuar konceptin (të diversitetit) e integrimit në jetesën në botën globale të diversiteteve.

**Kompetenca interkulturore** janë përmbledhja e domeneve, qëndrimeve, sjelljeve, shkathtësive dhe vlerave, në funksion të realizimit të dialogut interkulturore dhe integrimit interkulturore.

# PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet në të cilat mbështetet ky dokument janë nxjerrë nga një dokument ndërkombëtar dhe disa dokumente vendore. Dokumenti ndërkombëtar është UNESCO - *Doracak për arsim interkulturore*, ndërsa nga dokumentet vendore *Ligji i arsimit fillor* (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 161/19), *Konceptioni për aktivitete jashtëshkollore në arsimin fillor*, si dhe *Konceptioni për arsim fillor*.

1

**UNESCO - Doracaku për arsim interkulturore i përmban parimet si vijon:**



Arsimi interkulturore respekton identitetin kulturor të nxënësit, përmes sigurimit të arsimit kulturor të pranueshëm, përkatës dhe cilësor për të gjithë;



Arsimi interkulturore i mundëson secilit nxënës të përvetësojë domene, shkathtësi dhe qëndrime, të domosdoshme për integrimin e tij aktiv dhe të plotë në shoqërinë multikulturore;



Arsimi interkulturore i mundëson secilit nxënës të përvetësojë domene, shkathtësi dhe qëndrime që do t'i mundësojnë të kontribuojë në mirëkuptimin, respektimin, tolerancën, solidaritetin dhe bashkëpunimin mes individëve të grupeve të ndryshme etnike, sociale, kulturore dhe religjioze;

---

## 2

**Ligji i arsimit fillor („Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 161/19 dhe 229/20“)**

Në përputhje me Ligjin e arsimit fillor, parimet për arsimin fillor në të cilat bazohet ky dokument janë:

- ➔ Interesimi më i mirë dhe zhvillimi i plotë i nxënësit;
- ➔ Barazi, disponueshmëri, qasshmëri dhe inkluzivitet;
- ➔ Avancim i ngjashmërive dhe pranim i diversiteteve, interkulturalizëm, multikulturalizëm.

Gjithashtu, dokumenti bazohet edhe në nenin 5 të ligjit të njëjtë, respektivisht kapitullin “Mbrojtje nga diskriminimi dhe promovim i barazisë” në të cilin thuhet: „Në edukimin dhe arsimin fillor ndalohet çdo diskriminim direkt ose indirekt, thirrje dhe nxitje të diskriminimit dhe ndihmë në veprimin diskriminues në bazë të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes kombëtare ose etnike, aftësisë së kufizuar, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, ...“

## 3

**Koncepcioni për aktivitete jashtëshkollore në arsimin fillor**

Në *Koncepcionin e aktiviteteve jashtëshkollore* është theksuar se:

- ➔ Aktivitetet jashtëshkollore zhvillojnë kompetenca interkulturore të nxënësit.

Shkolla duhet të ofrojë aktivitete jashtëshkollore përmes të cilave do ta nxisë zhvillimin e kompetencave interkulturore të nxënësit dhe do të promovojë karakterin multikulturore të shtetit tonë. Kjo mund të bëhet përmes: (1) përfshirjes së përmbajtjeve multikulturore që sigurojnë njohuri për dallimet dhe për ngjashmëritë në kulturat e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në vendin tonë, (2) sigurimit të bashkëveprimit të nxënësve të cilët mësojnë në një gjuhë mësimore me nxënës të cilët mësojnë në gjuhë tjetër mësimore, dhe/ose (3) përfshirjes së përmbajtjeve multikulturore në aktivitete që sigurojnë bashkëveprim mes nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore (kombinim i dy qasjeve të përmendura paraprakisht).

## 4

### *Koncepti për arsimin fillor*

Kapitulli i parë i konceptit ka të bëjë me sigurimin e inkluzionit, barazisë gjinore dhe interkulturalizmit, me ç'rast interkulturalizmi në arsimin fillor do të mundësojë:

- ➔ Ndjenjën e barazisë/barabarësisë të nxënësit e grupeve të rrezikuara;

---

- ➔ Nxënësit të zhvillojnë kompetenca interkulturore;

---

- ➔ Nxënësit ta ndërtojnë identitetin kombëtar që rezulton nga përkatësia e shtetit të përbashkët – Republika e Maqedonisë së Veriut;

---

- ➔ Integrim më i mirë ndëretnik në arsimin dhe kohezion social në shoqërinë.

---

# PËRCAKTIM I STANDARDEVE

Në këtë pjesë është përkufizuar standardi dhe janë përcaktuar karakteristikat që janë respektuar gjatë përpilimit të tyre.

Standardi paraqet *deklaratë për domene të shkathtësitë dhe zotësitë, si dhe vlerat, respektivisht qëndrimet me qëllim të arritjes së tyre nga nxënësit në moshë të caktuar, respektivisht nivel të arsimit*. Kjo nënkupton se standardet duhet të jenë të formuluar në shprehje të qarta, matëse për pritjet, të shprehura në formë të epilogëve nga nxënësia. Me standardet qëllime arsimore edhe detyrat konkretizohen përmes përshkrimeve të kuptueshme, empirike matëse për arritjen, respektivisht sjelljen e nxënësve.

Duke marrë parasysh se standardet duhet të jenë të bazuara në të dhënat empirike, niveli i realizimit të tyre mund të matet nga periudha në periudhë, respektivisht nga viti në vit. Kjo, gjithashtu, do të thotë se cilido standard nuk është i përcaktuar një herë e përgjithmonë. Në fakt, rekomandohet që të njëjtat të rishikohen në periudhën prej 4-5 viteve, varësisht nga dinamika e arritjes së tyre. Vendosja e standardeve është proces i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me përmbajtjen, me rrethanat, me kontekstin historik, shoqëror, politik, por edhe shkencor.

Gjatë përkufizimit të standardeve është marrë parasysh që ato të kenë **karakteristikat** si vijon:

## a) Verifikueshmëri të epilogëve të specifikuar

Kjo do të thotë se standardi arsimor duhet të lidhet me domene, zotësi, shkathtësi dhe qëndrime konkrete, matëse, specifike;

## b) Kuptueshmëri

Standardet evropiane janë formuluar në mënyrë të qartë, koncize dhe të saktë me terme të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në sistemin arsimor;

## c) Realizueshmëri

Standardet arsimore paraqesin sfida arsimore, por megjithatë jo aq të mëdha që të mos mund të jenë të realizuara. Kjo do të thotë se do të jenë të përkufizuara në nivel themelor, me çka do të ishin të realizueshme gjatë procesit arsimor për të gjithë;

#### ç) Fokus në domenet themelore

Kjo do të thotë se standardet i konkretizojnë epilogët themelorë nga nxënia, respektivisht domenet strukturore, aftësitë dhe shkathtësitë, ato nuk e paraqesin në detaje fushën e përgjithshme të arsimit interkulturore ose, nga ana tjetër, nuk tentojnë ta zbulojnë përmbajtjen e përgjithshme, por vetëm atë më të rëndësishmen, respektivisht më të domosdoshmen;

#### d) Kumulativiteti

Që do të thotë se standardet duhet të shkojnë gradualisht, çdo nivel i ardhshëm i domenit, zotësisë, shkathtësisë, e supozon miratimin e nivelit paraprak;

#### dh) Detyrueshmëria

Kjo do të thotë se kompetencat e përkrahura në standardet janë të detyrueshme për të gjithë nxënësit në procesin arsimor;

#### e) Diferencimi

Standardet duhet të jenë të diferencuara qartë edhe atë:

##### ✓ | **diferencimi sipas cikleve arsimore:**

Standardet në këtë dokument janë bërë me **diferencimin sipas cikleve arsimore**. Ky diferencim është pedagogjik-formal, respektivisht ai e ndjekë sistemin arsimor kombëtar dhe ndarjen e tij në cikle arsimore të arsimit fillor: niveli 1: nga 6-9 vjeç (kl. I-III), niveli 2: nga 9-12 vjeç (kl. IV-VI), dhe niveli 3: nga 12-15 vjeç (kl. VII-IX).

##### ✓ | **diferencim sipas domeneve:**

Kompetencat interkulturore shprehen përmes domeneve si vijon:

1. dituria dhe të kuptuarit
2. shkathtësi dhe zotësi dhe
3. vlera dhe qëndrime

Në këtë kuptim do të mund të thuhej se kompetencat interkulturore kanë të bëjnë me "nxënie për të ditur", "nxënie për të bërë" dhe "nxënie për të qenë". Nxënia për të ditur është hapi i parë në përvetësimin e kompetencave interkulturore. Nxënia për të bërë është momenti aktiv, me të cilin fillon bashkëveprimi me të tjerët gjatë të cilit dituria e përvetësuar zbatohet, por edhe përvetësohet dituri e re në mënyrë kthyesë, përmes vetë procesit të bashkëveprimit. Nxënia për të qenë, në fakt është krijim i "individit interkulturore", individ i aftësuar që përmes mendimit dhe sjelljes refleksive dhe kritike, të hyjë në lidhje të shëndosha dhe të frytshme me kultura të ndryshme, të jetë qytetar produktiv në botën globale dhe të larmishme.



# LIDHSHMËRI ME STANDARDET KOMBËTARE

Standardet interkulturore janë të lidhura me Standardet kombëtare<sup>13</sup> mbi të cilat, sipas Konceptcionit për arsimin fillor, bazohet në programin e përgjithshëm për arsim fillor. Standardet kombëtare janë më të përgjithësuara dhe kanë të bëjnë me atë që nxënësit duhet ta dinë dhe të jenë të zotët ta bëjnë kur do ta mbarojnë arsimin fillor, si dhe me qëndrimet dhe vlerat që duhet t'i përvetësojnë. Standardet interkulturore në këtë dokument janë të konkretizuara, janë veçuar kompetencat kryesore interkulturore që më pas janë zhvilluar për secilin cikël arsimor në arsimin fillor (fondi i klasës së tretë, gjashtë dhe nëntë).

Në **tabelën 1** janë veçuar të gjitha kompetencat nga Standardet kombëtare që kanë të bëjnë edhe me kompetencat interkulturore, ndërsa në **tabelën 2**, në fillim për secilin grup të kompetencave interkulturore është përmendur se me cilat standarde kombëtare janë të lidhura.

**Tabela 1. Standarde kombëtare të lidhura me kompetencat interkulturore<sup>14</sup>**

II.	Gjuhë e dytë e huaj, gjuha shqipe dhe gjuha e bashkësisë
II – B.1	Përmes mësimit të një gjuhe tjetër lehtësohet nxënia e më shumë gjuhëve dhe mundësia për të komunikuar me pjesëtarë të kulturave/ grupeve gjuhësore të ndryshme;

<sup>13</sup> standardi-USVOENI.pdf (mon.gov.mk)

<sup>14</sup> Në tabelën me numër romak është shënuar fusha në standardet, shenja A ka të bëjë me dituri dhe zotësi, ndërsa shenja B me qëndrime dhe vlera, derisa numri arab shënon numrin rendor të diturisë/zotësisë, respektivisht qëndrimi në fushën konkrete

**V.****Zhvillim personal dhe social**

- V-A.1** T'i identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit personal që ndërtohet në bazë të përkatësisë ndaj grupeve të ndryshme sociale (p.sh. identiteti gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe roleve të ndryshme që i ka në jetë (p.sh. nxënës, bir/bijë);
- V-A.15** T'i dallojë problemet në relacionet me të tjerët dhe t'i qaset në mënyrë konstruktive zgjidhjes së konflikteve, duke i respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira;
- V-B.5** Nga mënyra e qasjes në zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e konflikteve varet nëse problemet do të jenë të zgjidhura, respektivisht nëse konfliktet do të jenë të zgjidhura.

**VI.****Shoqëri dhe kulturë demokratike**

- VI-A.1** Të sqarojë se si faktorët shoqëror ndikojnë në personalitetin dhe mjedisin dhe t'i marrë parasysh gjatë formimit të mendimit dhe marrjes së vendimeve;
- VI-A.5** T'i kuptojë dallimet mes njerëzve mbi çfarëdo baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status social, orientim seksual, etj.);
- VI-A.6** Të dallojë prani të stereotipave dhe paragjytimeve te vetja dhe te të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;

---

<b>VI-A.8</b>	Të shqyrtojë se çfarë i lidhë, e çfarë i ndan njerëzit në bashkësinë, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e bashkësisë, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
<b>VI-A.13</b>	Të analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, të identifikojë raste të shkeljes së të drejtave dhe të ndërmarrë aktivitete për respektimin joselektiv të tyre;
<b>VI-A.20</b>	Të sqarojë rolin e organizatave dhe aleancave ndërkombëtare në shoqërinë bashkëkohore dhe t'i analizojë vlerat dhe përfitimet nga integrimi evropian;
<b>VI-A.21</b>	Të dallojë rëndësinë e termeve: komb, popull, bashkësi etnike, qytetarë dhe individë; të dukurive: përkatësi etnike dhe kombëtare, patriotizëm dhe nacionalizëm, shumicë dhe pakicë; si dhe të koncepteve: territor, rajon, shtet, shoqëri, pushtet, etj. dhe t'i shfrytëzojë në mënyrë përkatëse në kontekstet e ndryshme me të cilat kanë të bëjnë;
<b>VI-A.26</b>	T'i sqarojë migrimet dhe ndryshimet e popullsisë dhe lidhshmërinë e tyre me ndryshimet shoqërore (sociale, ekonomike, kulturore, politike);
<b>VI-A.27</b>	Ta rrëfejë dhe ta sqarojë historinë (sociale, kulturore dhe politike), të popullit të tij dhe historitë e popujve të tjerë që jetojnë në vendin tonë dhe në rajon, me veçoritë e tyre dhe në kontekst të së kaluarës së ndarë historike;

---

---

<b>VI-A.28</b>	T'i rrëfejë dhe t'i sqarojë ngjarjet historike në nivel botëror (nga aspekti social, kulturor dhe politik) që janë të rëndësishme për zhvillimin e qytetërimit, për formimin e kombeve dhe për marrëdhëniet mes popujve dhe shteteve në kushte bashkëkohore;
<b>VI-A.29</b>	T'i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë mes religjioneve më të përfaqësuara në botë dhe ateizmit/agnosticizmit, me theks të veçantë në normat dhe vlerat etnike që i përfaqësojnë;
<b>VI-B.1</b>	Nuk guxon të bëjë diskriminim në bazë të dallimeve mes njerëzve (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status social, orientim seksual, etj.);
<b>VI-B.3</b>	Të drejtat e njeriut janë universale, ndërsa kufijtë e të drejtave të secilit njeri janë të drejtat dhe liritë e tjetrit;
<b>VI-B.4</b>	Respektimi joselektiv i të drejtave dhe lirive të njeriut është kyç për mirëqenien e individëve dhe për shoqërinë në tërësi;
<b>VI-B.5</b>	Barazia, barabarësia dhe kohezioni social janë të domosdoshëm për funksionimin e suksesshëm të bashkësisë;
<b>VI-B.6</b>	Angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishëm për realizimin e interesit të përbashkët publik;
<b>VI-B.12</b>	Shteti ynë është shoqëri multikulturore/multi-etnike në të cilën jetojnë kultura/etnikume të ndryshme dhe secili qytetar i tij është përgjegjës për të kontribuar për shkëmbimin interkulturore dhe respektimin e të drejtave në interes të jetesës së përbashkët në shoqëri të integruar, kohezive në aspektin etnik;

---

- VI-B.13** Identiteti kombëtar, që rezulton nga përkatësia ndaj shtetit Republika e Maqedonisë së Veriut, është komponentë e rëndësishme e identitetit të të gjithë qytetarëve të shtetit.

## VIII.

### Shprehje artistike dhe kulturore

- VIII-A.1** T'i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë mes kulturës personale dhe kulturave të tjera në mjedisin e tij më të ngushtë dhe më të gjerë dhe të analizojë lidhshmërinë dhe ndërvarësinë e tyre;
- VIII-A.8** Të dallojë kuptimin dhe t'i sqarojë përfitimet dhe sfidat nga globalizimi dhe lidhshmërinë e çështjeve lokale me zhvillimet globale;
- VIII-A.9** Ta dallojë dhe sqarojë si kulturë të cilës i takon (duke përfshirë edhe traditën dhe religjionin) dhe e cila ka ndikuar në formimin e identitetit të tij/saj dhe këndvështrimit ndaj botës;
- VIII-A.10** T'i identifikojë dhe rishikojë stereotipat dhe paragjykimet ndaj pjesëtarëve të grupeve të tjera kulturore që manifestohen në rrethimin e tij/e saj;
- VIII-A.13** Të interpretojë botën jo vetëm nga pikëpamja e pjesëtarëve të kulturës personale, por edhe përmes perspektivës së kulturave të tjera;
- VIII-B.3** Respektimi dhe promovimi i kulturës personale kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;

---

**VIII-B.4** Diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme;

---

**VIII-B.5** Vlerësimi i kulturave të tjera (duke përfshirë edhe të religjioneve të tjera) është i gabueshëm dhe destruktiv – nuk ka kultura më të mira dhe më të këqija, por vetëm dallime në manifestimin e kulturave të ndryshme;

---

**VIII-B.6** Dallimet mes kulturave duhet të shikohen si mundësi për nxënie dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;

---

**VIII-B.7** Respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit për kulturën personale nga ana e të tjerëve;

---

# STANDARDE PËR ARSIM INTERKULTURORE

## TERME THEMELORE NË PËRKUFIZIMIN E STANDARDEVE

Gjatë përcaktimit të standardeve ndiqet parimi si vijon: janë përkufizuar termet themelore nga korpusi i multikulturalizmit dhe integritit interkulturore dhe në bazë të tyre janë zhvilluar standarde përkatëse. Ato paraqesin fusha të veçanta, ose ide themelore që nxënësi duhet t'i përvetësojë nga kjo fushë deri në përfundimin e arsimit të tij themelor. Është e vështirë të ndahen këto terme themelore për shumë arsye. Pa u futur në elaborim të detajuar, në vazhdim janë përmendur shtatë termet themelore për të cilat vlerësojmë se e përfshijnë tërësisht fushën e multikulturalizmit dhe integritit interkulturore. Ato janë:

1. Identitet kulturor;
2. Multikulturë;
3. Interkulturë;
4. Drejtësi dhe barazi sociale;
5. Stereotipa dhe paragjykime;
6. Paqe dhe zgjidhje paqësore e konflikteve;
7. Globalizim.

Për secilin nga termet/fushat e përmendura nga interkultura janë zhvilluar **standarde për arsim interkulturore** në bazë të **kompetencave (domene dhe mirëkuptim, shkathhtësi/zotësi/sjellje, vlera dhe qëndrime) për secilin cikël** të arsimit fillor.

Tabela 2. Kompetenca interkulturore

## Identitet kulturor

(I lidhur me standardet kombëtare II-B.1; V-A.1; VI-A.1; VI-A.21; VI-B.13; VIII-A.1; VIII-A.9; VIII-B.3)

CIKLI I PARË		
Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Përshkruan karakteristika të grupeve të ndryshme (kulturore)	Përshkruan, vizaton diagrame, i lidhë karakteristikat e grupeve të ndryshme të cilave u përket.
Shkathësi/zotësi/sjellje	Prezanto veten si pjesëtarë të grupeve të ndryshme (kulturore)	Në mënyrë verbale, përmes testit ose vizatimit prezanton veten dhe veçoritë e tij që e bëjnë pjesëtar/pjesëtare të grupit të caktuar.
Vlera dhe qëndrime	Konsideron se është me rëndësi të jesh pjesë e grupeve të ndryshme (kulturore)	Përfshihet në aktivitete të grupeve të ndryshme moshatare dhe sqaron me fjalë të tij (në mënyrë përkatëse me moshën) pse dëshiron të jetë pjesë e grupit.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit bëjnë listë të veçorive (ose hartë mendore) në temën "Kush jam unë". Në grupe të vogla i sqarojnë njëri-tjetrit çfarë është ajo që u është e rëndësishme që të tjerët ta dinë për ta dhe pse. Më pas gjejnë sipas cilave veçori dhe shprehi janë të njëjtë, e sipas të cilave dallojnë. Secili grup i tregon gjërat e përbashkëta, ndërsa mësimdhënësi i shkruan në tabelë. Mësimdhënësi bën përmbledhjen se çfarë është e përbashkët për numrin më të madh të nxënësve në paralelen.
- ➔ Secili nxënës merr detyrë të gjejë 5 nxënës në klasë që u përkasin grupeve të ndryshme (p.sh. ushtrojnë ndonjë sport, luajnë në instrument, duan të vizatojnë, shkruajnë këngë, kanë kanakare në shtëpi, kujdesen për lule, kanë marrë pjesë në ndonjë aksion për të ndihmuar ndonjë shok). Kur do të gjejë një nxënës të tillë e shënon emrin e tij në listë. Kur do të gjejë 5 nxënës bërtet "Bingo". Ngjiten fletët në tabelë dhe bisedohet për atë se cilave grupe u takojnë nxënësit dhe si mund të kontribuojë kjo për paralelen.
- ➔ Nxënësit vizatojnë tre vizatime. Në vizatimin e parë vizatojnë vetveten, në të dytin vendin e tij/saj të preferuar dhe në të tretin lëndën e tij/saj të preferuar. Më pas nxënësit tregojnë pse e kanë vizatuar pikërisht atë. Ekspozohen vizatimet dhe sërish zhvillohet diskutim për atë se janë të ngjashme dhe të ndryshme vizatimet. Në bazë të diskutimit konstatohet se secili prej nesh ka identitetin e tij që mund të jetë i njëjtë, por edhe i ndryshëm nga të tjerët.
- ➔ Shkolla organizon gjatë një jave aktivitete të ndryshme në të cilat nxënësit e paraqesin kulturën e tyre ose dhe/ose kulturat tjera përmes vizatimeve, sendeve, shfaqjeve, ushqimit, këngëve, lojërave sportive.

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron se cilat veçori dhe sjellje i ndan me pjesëtarët e kulturës së saj	Krahason veçori të pjesëtarëve të grupeve të ndryshme, identifikon karakteristika të përbashkëta të grupit të tij kulturor dhe sqaron se si ndërlidhen ato.
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Hulumton se si rrethimi kulturor (familja, moshatarët, personalitete nga jeta publike, etj.) ndikojnë ndaj mendimit, sjelljes, të menduarit, etj. të dikujt tjetër.	Shfrytëzon mënyra të ndryshme për grumbullimin e të dhënave (intervista, anketa, tekste, hulumtime) i analizon dhe konkludon për ndikimet e rrethimit të tyre në formimin e shprehive dhe sjelljeve të caktuara.
Vlera dhe qëndrime	Është i gatshëm/hapur të dëgjojë dhe mësojë nga dhe për kulturat tjera.	Interesohet për kultura të tjera (lexon, pyet, shikon filma).

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Secili nxënës shkruan letër të imagjinuar nga paraardhësit e tij në të cilën i japin këshilla për jetën. Në grupe prej disa nxënësve i lexojnë letrat dhe bisedojnë se çfarë porosi të ngjashme, e çfarë të ndryshme “kanë marrë”. Bisedojnë se pse është kjo kështu, çfarë nga ajo ata të pranojnë, e çfarë u duket “e vjetruar” dhe pse.
- ➔ Nxënësit do të vizatojnë lule me shumë fletë, në secilën fletë të lules duhet të shkruajnë individë (nga jeta private ose publike) që u janë model. Më pas bashkohen në grup dhe gjejnë se cilët u janë modelet e përbashkëta. Diskutojnë se çfarë sjelljesh, vlerash kanë ata, pse duan t’u ngjajnë atyre, etj.
- ➔ Nxënësit shkruajnë 10 karakteristika ose informacione më interesante që do t’i ndanin gjatë njohjes me dikë tjetër. Për shembull, emri, mosha, gjinia, nacionaliteti, roli familjar, religjioni, përkatësia etnike, lënda e preferuar, shija muzikore, hobi, sport, etj.. Më pas nxënësit shpalosin se sa karakteristika të përbashkëta i kanë dhe pse kanë zgjedhur të prezantohen përmes atyre karakteristikave.
- ➔ Nxënësit në fleta të mëdha prej letrës me pyetje si: Kush flet në shtëpi në gjuhë tjetër, kush dëshiron të ha ushqim italian, kush ka më shumë se dy vëllezër dhe motra i shënojnë emrat e tyre. Nga përgjigjet e ekspozuara shihet se secili prej nxënësve u përket më shumë grupeve. Zhvillohet diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet, nëse shoqërohen vetëm me fëmijë që u janë të ngjashëm ose edhe me fëmijë që janë të ndryshëm, për çfarë ende dallojnë, çfarë i afron, e çfarë i largon. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secili duhet të përpilojë dhe dramatizojë situatë në të cilën njerëzit të cilët janë të ndryshëm njoftohen dhe bëhen shokë.

- ➔ Secili nxënës nga shtëpia sjellë diçka që i ndihmon ta kuptojë dhe ta prezantojnë përkatësinë e tij kulturore dhe për dy minuta para paraleles e përshkruan atë që e ka sjellë dhe sqaron pse dhe si kjo i ndihmon që ta prezantojë identitetin e tij kulturor. Më pas gjejnë se çfarë kanë të përbashkët, e çfarë të veçantë në identitetin kulturor dhe bisedojnë për identitet të shumëfishtë.
  - ➔ Nxënësit lexojnë tregime ose vepra më voluminoze ose shikojnë film në të cilat përshkruhet kultura e jetesës, mësimdhënësi në mënyrë të udhëzuar, përmes pyetjeve, i nxitë të mendojnë dhe të bisedojnë për çështje të identitetit kulturor.
  - ➔ Shkolla/mësimdhënësi vendosë bashkëpunim me shkollat nga vendet tjera, me gjuhë të ndryshme mësimore dhe nxënësit kontaktojnë përmes rrjeteve elektronike, vizitohen, organizojnë ngjarje të ndryshme dhe njoftohen me veçori dhe ngjashmëri kulturore.
  - ➔ Shkolla organizon, gjatë një jave, aktivitete të ndryshme në të cilat nxënësit e prezantojnë kulturën e tyre dhe/ose kultura të tjera përmes vizatimeve, sendeve, shfaqjeve, ushqimit, këngëve, lojërave sportive.
-

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Dallon dhe përshkruan rolin që e ka kultura në formimin e identitetit personal dhe kolektiv.	Sqaron me gojë ose me shkrim konceptin e identitetit dhe formimin e tij nën ndikimin e kulturës.
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Diskuton në mënyrë të argumentuar për nevojën e respektit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme kulturore dhe për sfidat gjatë bashkëpunimit.	Në eseje, fjalime, diskutime verbale nxjerr argumente relevante për përfitimin nga bashkëpunimi i pjesëtarëve të kulturave të ndryshme dhe për sfidat e mundshme.
Vlera dhe qëndrime	Vlerëson përkatësinë e tij/saj kulturore dhe është i/e hapur për pranimin kritik të ndikimeve nga kulturat tjera.	Përmes sjelljes, shkrimit, të folurit tregon krenari për shkak të përkatësisë ndaj kulturës së vet dhe pranon në mënyrë të argumentuar ndikimet e ndërsjella të kulturave.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit duhet të imagjinojnë se do të qëndrojnë te një shok nga një vend tjetër (ose se do të pranojnë mysafirë nga një vend tjetër). Duhet të shkruajnë letër në të cilën do t'i prezantojnë shprehitë kulturore të jetesës së të rriturve dhe fëmijëve (të ushqyerit, shoqërimi, rregulla të sjelljes) dhe të pyesin se çfarë është me rëndësi të dinë nëse ata udhëtojnë. Më pas lexojnë disa nga letrat dhe diskutojnë nëse i kanë shkruar gjërat e rëndësishme për kulturën e vet dhe për shqetësimet që njerëzit i kanë gjatë takimit me kultura të ndryshme.

---

- ➔ Secili nxënës merr fletë pune me vizatim të akullnajës në të cilën duhet në pjesën mbi ujë t'i shënojë karakteristikat e identitetit që janë të dukshme, e në pjesën nën ujë ato që nuk janë të dukshme (disa nga karakteristikat kulturore mundet paraprakisht në fleta vetëngjithëse të shkruhen nga mësimdhënësi). Më pas nxënësit bisedojnë për atë se cilat veçori të ndryshme janë në majën e akullnajës, e cilat në fundin dhe si ndikon kjo në të kuptuarit e ndërsjellë.

---

- ➔ Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili grup përpilon "kulturën" e tij (mënyrën e sjelljes, aktivitete, shprehje të emocioneve, pranim të huajve) dhe "e zbaton" (grupet janë në hapësira të ndara). Më pas nga një vëzhgues e viziton grupin tjetër dhe tenton që atë që e ka parë t'ia transmetojë grupit të tij në mënyrë që të vendoset bashkëpunim. Grupi bën strategji për bashkëpunim dhe në fazën e radhës dërgon grup të vogël të "emisarëve". Ata ia transmetojnë përvojat grupit të radhës të "emisarëve". Në fund bashkohen grupet dhe diskutojnë për përvojat me kulturën e panjohur, sa e kanë mësuar, si kanë bashkëpunuar, çfarë u ka paraqitur problem, çfarë kanë mësuar nga simulimi për dallimet dhe bashkëpunimin real kulturor.

---

- ➔ Nxënësit lexojnë tregime ose vepra më voluminoze ose shikojnë film në të cilat përshkruhet kultura e jetesës, mësimdhënësi në mënyrë të udhëzuar, përmes pyetjeve, i nxitë të mendojnë dhe të bisedojnë për çështje të identitetit kulturor.

- ➔ Shkolla/mësimdhënësi vendosë bashkëpunim me shkollat nga vendet tjera, me gjuhë të ndryshme mësimore dhe nxënësit kontaktojnë përmes rrjeteve elektronike, vizitohen, organizojnë ngjarje të ndryshme dhe njoftohen me veçori dhe ngjashmëri kulturore.
  - ➔ Shkolla organizon, gjatë një jave, aktivitete të ndryshme në të cilat nxënësit e prezantojnë kulturën e vet dhe/ose kultura të tjera përmes vizatimeve, sendeve, shfaqjeve, ushqimit, këngëve, lojërave sportive.
-

## Multikulturë

(E lidhur me standardet kombëtare: VI-A.5; VI-A.21; VI-A.27; VI-A.29; VI-B.1; VI-B.12; VIII-B.5; VIII-B.7)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Dallon ekzistimin e grupeve të ndryshme kulturore në rrethimin	Identifikon dhe përshkruan karakteristika të dukshme të grupeve kulturore që janë më të përfaqësuara në rrethimin.
Shkathësi/zotësi/sjellje	Pranon sjellje dhe praktika të ndryshme kulturore	Sqaron dallime kulturore në rrethimin e drejt-përdrejt dhe e sqaron të drejtën e individëve për të praktikuar kulturën e tyre.
Vlera dhe qëndrime	Shprehë respekt ndaj kulturave të ndryshme	Interesohet për kultura të tjera dhe nuk i diskriminon pjesëtarët e saj.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Secili nxënës e thotë emrin e tij dhe tregon se kush ia ka dhënë, çfarë do të thotë, nëse e ka marrë sipas dikujt, a do të donte të quhet më ndryshe, a njeh fëmijë të tjerë me emër të njëjtë, a di emra të fëmijëve nga vendet tjera. Përmes këtij aktiviteti nxënësit përvetësojnë vetëdijje fillestare për kulturën e vet.
- ➔ Mësimdhënësi me nxënësit hulumton lojëra tradicionale të fëmijëve nga vendet tjera, fëmijët mësojnë të luajnë. Aktivitetet mund të pasurohen me lojëra nga pjesë të ndryshme të shtetit.
- ➔ Në karton të madh është vizatuar rrugë e shtrembër, e ndarë në 20 fusha, në të cilat janë shkruar fjalitë e filluara përmes të cilave nxënësi tregon diçka për veten si p.sh.: Unë ndjej kënaqësi të..., Dalloj nga të tjerët sipas..., Për mua shkolla është..., Tendoj të..., E di si të..., Dua të jem si..., Asnjëherë nuk..., Merrem me..., Te ne në shtëpi të gjithë..., Asnjëherë nuk kam qenë në..., Nëna ime nuk më lejon të..., Çdo javë ne..., etj. Në tri fusha (në distancë prej 3-5 fushave) janë shënuar instruksione: Kthehu 2 fusha mbrapa, Kthehu 3 fusha mbrapa, Kthehu 4 fusha mbrapa. Nxënësit në grupe me nga 4 e luajnë lojën në atë mënyrë që secili hedhë zarin dhe duhet ta plotësojë fjalinë e shkruar në fushën me numrin që i ka ra. Pas lojës me gjithë klasën zhvillohet diskutimi që nxënësit në mënyrë interesante kanë mësuar për të tjerët.
- ➔ Nxënësit ndahen në çifte ose në grupe të vogla. Mësimdhënësi u tregon nxënësve fotografi të njerëzve me mbulesa të ndryshme për kokë (kaçketë, shubarë, plis, shall, sheshir, beretë). Grupet me tërheqje marrin nga një fotografi. Duhet të bisedojnë për atë që u tregon mbulesa për kokë për njeriun/gruan (nga cili vend e ka origjinën, si jetohej atje, si është klima). Mund të shkruajnë histori të shkurtër për të që do ta lexojnë para të tjerëve. Nxënësit tregojnë se cila mbulesë për kokë u pëlqen më së shumti, cilën do ta kishin mbajtur, çfarë mbulesa mbahen te ata në familje. Mund të mbledhin ekzemplarë të mbulesave të ndryshme për kokë dhe të bëjnë ekspozitë në hollin e shkollës.

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Identifikon përfitime nga jetesa në një mjedis multikulturor	Numëron dhe sqaron përfitime nga jetesa në mjedis me kultura të ndryshme
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Hulumton veçoritë kulturore të tij/saj dhe të tjera	Realizon anketa, projekte për kulturën e vet dhe kulturat tjera në rrethimin.
Vlera dhe qëndrime	Angazhohet për respektimin dhe mbështetjen e kulturave të tjera në rrethimin	Merr pjesë në aktivitete për promovimin e kulturave të ndryshme, nuk diskriminon në bazë të dallimeve kulturore.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit lexojnë shënime në ditarë ose letra të dy fëmijëve të kulturave të ndryshme që kanë qenë në vizitë, në të cilat shihet befasia nga disa zakone, shprehi dhe mendime lidhur me këtë. Më pas bisedojnë për ndjenjat e fëmijëve kur janë hasur në mjedis tjetër të ri, rrëfejnë përvoja personale, shprehin mendimet e tyre për dallimet kulturore.
- ➔ Nxënësit pa zgjedhur marrin nga një copë pemë (limon/portokall/mollë). Secili e shqyrton me kujdes copën e tij dhe e “prezanton” para të tjerëve. Më pas zhvillohet diskutim se edhe gjërat që janë shumë të ngjashme, në fakt janë të ndryshme. Diskutimi kalon në dallime dhe ngjashmëri mes individëve në grupe të ndryshme (meshkuj, femra, nga fshati, nga qyteti, nga një rajon, vend i caktuar).
- ➔ Mësimdhënësi u ndan nxënësve harta me fotografi që paraqesin kultura të ndryshme. Nxënësit në grupe të vogla duhet t’i identifikojnë me cilën kulturë kanë të bëjnë dhe çfarë di për të. Më pas i prezantojnë në mënyrë që të njoftohen me karakteristikat e kulturave të tjera dhe ngjashmëritë dhe dallimet me kulturën personale.
- ➔ Nxënësit studiojnë se çfarë roli ka buka në kultura të ndryshme (çfarë buke gatuhet, si dhe sa hahet, zakone të lidhura me bukën, receta/mund edhe t’i bëjnë) dhe në këtë mënyrë mësojnë për kultura të tjera. Diskutojnë për shkëmbimin e recetave dhe përvojave me ushqim nga kulturat tjera. Nxënësit (në grupe) mund të përgatisin afishe/libër/prezantim në këtë temë.
- ➔ Nxënësit mbledhin artefakte (fotografi, sende, tekste) për kultura të ndryshme dhe organizojnë ekspozitë dhe prezantim për kulturat që i kanë hulumtuar.

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Identifikon dhe sqaron ngjashmëri dhe dallime mes kulturave dhe vlerave kulturore	Sqaron ngjashmëri dhe dallime mes pjesëtarëve të kulturave të ndryshme.
Shkathtësi/zotësi/ sjellje	Gjen dhe shfrytëzon mekanizma për pranimin e vlerave të ndryshme kulturore për të mirën e përgjithshme dhe interesin e përbashkët	Organizon aktivitete në të cilat përfshin pjesëtarë të grupeve të ndryshme kulturore.
Vlera dhe qëndrime	Beson në përfitimet nga jetesa në mjedis multikulturor	Flet dhe shkruan për përfitime nga jetesa në shoqëri multikulturore dhe shoqërohet me pjesëtarë të kulturave të ndryshme në mjedisin.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Pjesëmarrësit masin me sy të mbyllur se sa zgjatë një minutë. Më pas diskutojnë për përjetimin e ndryshëm të kohës në kultura të ndryshme, për prejardhjen e atyre dallimeve, probleme që i krijojnë gjatë përzierjes së kulturave, dallime të tjera kulturologjike, se si të harmonizohen ato, etj.
- ➔ Nxënësit marrin role të këshilltarëve, kryetarit të komunës, kryesues të këshillit dhe inskenojnë seancë të këshillit në të cilën diskutohet për ndërtimin e kishës/xhamisë në një lagje. „Këshilltarët“ konsultohen paraprakisht me votuesit e tyre të cilët janë të ndarë në grupe me qëndrime të ndryshme. Pas “seancës” nxënësit diskutojnë për qëndrimet që i kanë përfaqësuar, liri të religjionit, tolerancë ndërfetare, etj.
- ➔ Nxënësit shikojnë film për dy individë të kulturave të ndryshme, Vjollca dhe Toni. Më pas e plotësojnë Diagramin e Venit për të demonstruar ngjashmëritë dhe dallimet mes pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike, me këtë rast duhet t’i marrin parasysh statusin e tyre social, kulturën, nevojat, etj. Nxënësit zhvillojnë diskutim për ngjashmëritë dhe dallimet mes pjesëtarëve të kulturave të ndryshme dhe mënyrën se si njohja e pamjaftueshme mund të rezultojë me keqkuptim.
- ➔ Nxënësit bëjnë hartë mendore për atë që secili prej tyre e nënkupton me kulturë. Më pas në grupe të vogla e plotësojnë dhe bëjnë hartën mendore të grupit. Hartat mendore ekspozohen, shqyrtohen dhe secili grup prezanton se çfarë ka mësuar nga termi kulturë.
- ➔ Nxënësit në ueb faqen shkruajnë për tema nga jetesa multikulturore (si jetohej në bashkësi të caktuara kulturore, në shoqëri të përziera kulturore, për sfidat e përshtatjes së jetës në mjedisin multikulturore ose në kulturë tjetër, për përvojat personale në situata të ndryshme kulturore, etj.).

## Interkultura

(E lidhur me standardet kombëtare: VI-A.8; VIII-A.13; VIII-B.4; VIII-B.6)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron çfarë ka mësuar për pjesëtarë të kulturave tjera (nga kontaktet personale, libra, filma)	Përshkruan karakteristika të pjesëtarëve të kulturave tjera nga mjedis i tij (gjuha që e flasin, muzika që e këndojnë dhe dëgjojnë, festat që i kremtojnë, etj).
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Hulumton se si njerëzit me veçori të ndryshme kulturore mund të bashkëpunojnë me njëritjetrin	Analizon dhe përmend veçori të përbashkëta të kulturave të ndryshme nga rrethimi i tij në bazë të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me moshatarë të kulturës së ndryshme.
Vlera dhe qëndrime	Dëshiron të shoqërohet me fëmijë - pjesëtarë të kulturave të ndryshme	Numëron mënyra të mundshme të shoqërimit me pjesëtarë të kulturave të tjera përmes aktiviteteve të organizuara nga/në shkoll-a/ë (lojëra/aktivitete të përbashkëta ose lojëra/aktivitete onlajn në grup).

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit shqyrtojnë kartelat me ilustrim me karakteristika të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme, shikojnë emisionin televiziv “Mëhalla jonë”, dëgjojnë këngë popullore të kulturave të ndryshme. Më pas zhvillohet diskutim për karakteristikat e kulturave të tjera në rrethimin e tij nga aspekti i gjuhës, traditave dhe zakoneve.
- ➔ Nxënësit të ndarë në dy grupe dhe të pozicionuar në anë të kundërta të klasës duhet ta qëllojnë ngjyrën e kartelës që e shikojnë, me atë që gjysma e nxënësve e shikojnë njërin, ndërsa të tjerët e shikojnë anën tjetër. Pasi që nxënësit do të thërrasin ngjyra të ndryshme mësimdhënësi ua tregon të dyja anët e kartelës me dy ngjyrat e ndryshme. Vijon diskutimi për atë se ajo që e shikojmë varet nga pozicionimi ynë. Mund të japin disa shembuj nga jeta reale.
- ➔ Nxënësit marrin nga mësimdhënësi fotografi që është e prerë në dy pjesë, në atë mënyrë që secila gjysmë ndaras “paraqet histori”, por që, së bashku, jep “histori më të ndryshme”. Ata duhet të shkruajnë çfarë mendojnë, për çfarë bëhet fjalë në fotografinë, kush janë personazhet nga fotografia dhe kërkohet që nxënësit t’i shqyrtojnë përshtypjet e tyre nga ajo që e kanë parë. Diskutimi pas analizimit të fotografive duhet të sigurojë analizë të mënyrave në të cilat i organizojmë dhe shqyrtojmë informacionet edhe atë se perceptimi ynë është i ndikuar nga paragjykimet.

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Veçon shembuj të mirë (nga librat, filmat, jeta e përditshme) të bashkëpunimit mes njerëzve të kulturave të ndryshme	Sqaron shembull pozitiv të bashkëpunimit me/mes pjesëtarëve të kulturave të ndryshme (përvojë personale ose nga filmi i shikuar, libri i lexuar).
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Organizon aktivitete me moshatarë të cilët u përkasin kulturave të ndryshme	Nuk bën diskriminim sipas përkatësisë kulturore në situatë kur duhet të organizojë aktivitete të caktuara.
Vlera dhe qëndrime	Angazhohet që fëmijët e ndryshëm të jenë të pranuar në grupet të cilave u përkasin	Sqaron shembuj personal dhe tregon ndjeshmëri ndaj shokëve pjesëtarë të kulturave të tjera.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit të ndarë në grupe lexojnë tekste në të cilat personazhet janë pjesëtarë të kulturave të ndryshme me detyrë që të gjejnë ngjashmëri dhe dallime të personazhet. Më pas prezantohet ajo që është punuar dhe zhvillohet diskutim me pyetje të përgatitura paraprakisht që shpijnë deri te rezultati i nxënies.
- ➔ Pjesëmarrësit mendojnë për takime me pjesëtarë të kulturës tjetër (perceptim, ndjenja, gjuhë, aktivitete). Më pas shkruajnë për takimin interkulturore sipas zgjedhjes së tyre, sipas udhëzimeve/pyetjeve të dhëna nga mësuesi. Të ndarë në grupe i rrëfijnë historitë e tyre. Pas rrëfimit, kthehen në grupin e madh/tërë paralelë dhe prezantohet dhe miratohet konkluzioni i përbashkët.
- ➔ Nxënësit luajnë rolin në bazë të skenarëve të përgatitur paraprakisht (shembuj pozitiv të interkulturës dhe shembujve të kundërt). Është me rëndësi që situatat në skenarët të jenë nga jeta reale. Pas prezantimit diskutohet sipas pyetjeve të përgatitura paraprakisht dhe miratohet konkluzioni i përbashkët për ndjeshmërinë ndaj pjesëtarëve të kulturave të tjera.

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron përparësitë dhe cilësinë e jetës së qytetarëve në shoqëri interkulturore	Identifikon dhe sqaron shembuj pozitivë të sjelljes interkulturore në jetën e përditshme.
Shkathtësi/zotësi/ sjellje	Fillon bashkëveprimin me njerëzit të cilët i përkasin ndonjë kulture tjetër dhe ia del me sukses në kontekste të ndryshme kulturore	Sqaron mënyra të ndryshme përmes të cilave i zhvillon kompetencat e tij interkulturore.
Vlera dhe qëndrime	Është i gatshëm për bashkëpunim me pjesëtarë të kulturave të ndryshme në drejtim të përparimit shoqëror	Jep ide për mënyra të mundshme të bashkëpunimit me moshatarë pjesëtarë të kulturave të tjera për njohje dhe bashkëpunim më të mirë.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit përgjigjen në kuis interkulturore individualisht dhe më pas për pyetjet që nuk i dinë kërkojnë ndihmë nga shokët (bashkënxënës nga grupi tjetër). Më pas diskutohet ndaras për çdo pyetje nga kuisi, për atë se cilat nga çështjet i kanë zgjidhur më vështirë dhe pse? Bashkërisht konkludohet se njerëzit të cilët jetojnë/ndajnë vendbanim të njëjtë duhet të njihen mirë mes vete në mënyrë që të bashkëpunojnë më mirë.
- ➔ Nxënësit marrin listë për kompetencë interkulturore që duhet t'i diskutojnë së bashku me moshatarin e tyre lidhur me atë se çfarë duan të përmirësojnë, e më pas diskutohet në grup dhe identifikohen deri në tre hapa për atë se çfarë do të duhej të bëjnë ata në mënyrë që t'i përmirësojnë kompetencat e tyre interkulturore.
- ➔ Pjesëmarrësit mendojnë për pesë festa më të rëndësishme që i kremtojnë bashkësi etnike, kultura, religjione të ndryshme, etj., që janë shumë të rëndësishme për shtetin tonë dhe t'i shkruajnë shkurtimisht në fletë ngjitëse së bashku me emrin e tyre. Më pas diskutohet për festat e njohura dhe për ato të panjohura për të cilat sqarim japin nxënësit që i kanë shkruar.

## Stereotipa dhe paragjytime

(Të lidhura me standardet kombëtare: VI-A.6; VIII-A.10)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Identifikon situata në të cilat ka pasur paragjytime për kulturën personale dhe të tjerëve	Dallon stereotipa dhe paragjytime për kulturën personale dhe të tjerëve në situata reale, tekste, fotografi dhe videomateriale nga jeta e përditshme.
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Nuk përdorë etiketim stereotipi të grupeve të ndryshme kulturore	Nuk tregon paragjytime dhe nuk përdorë etiketim stereotipi në sjelljen me moshatarë dhe moshatare.
Vlera dhe qëndrime	Është i vetëdijshëm se stereotipat dhe paragjykimet janë pengesë në komunikimin e ndërsjellë	Sqaron stereotip që vepron negativisht dhe e pengon komunikimin nga përvoja personale ose në situatë/tekst/film të caktuar.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit vihen në situatë që të mendojnë për ndonjë ngjarje kur kanë takuar dikë që ka qenë më ndryshe nga ai ose ajo në njëfarë mënyre, p.sh. nga ndonjë shtet tjetër, nga ndonjë bashkësi tjetër etnike, kanë pasur ngjyrë tjetër të lëkurës, kanë folur në gjuhë të ndryshme. Përshkrimin e situatës e bën sipas udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi, p.sh. kur ka ndodhur situata? Kush ishte ai? Çfarë bënte? Si keni biseduar? Si je ndjerë atëherë? Si është ndjerë ai/ajo? Si do të ishte sjellë nëse e takon sërish? A bëri ky takim ndonjë lloj ndryshimi te ti?
- ➔ Në grup të përzier të nxënësve realizohet aktiviteti "Domino" në të cilin nxënësit lidhen me njëri-tjetrin sipas shembullit të dominos, sipas karakteristikave të njëjta që i kanë mes vete me të cilat njoftohen me atë që njëri e thotë karakteristikën, e tjetri që e ka karakteristikën e njëjtë kapet për dore dhe tregon karakteristikën e tij të radhës. Konstatohet se pa marrë parasysh përkatësinë në kulturë tjetër të gjithë kemi karakteristika të njëjta që na lidhin.
- ➔ Mësimdhënësi përpilon skenarë për dramatizim të shakave që në të shumtën e rasteve janë të pranishme, në të cilat ka stereotipa. Pasi të prezantohen dramat e shkurtra diskutohet për stereotipat në dramën dhe ndërlidhen me situata nga jeta e përditshme.

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron se si stereotipat dhe paragjykimet ndikojnë në sjelljen e njerëzve	Dallon stereotipa dhe paragjytime për përkatësinë etnike ose kulturore në shprehje me shkrim ose me gojë dhe sqaron se si ato ndikojnë në sjelljen.
Shkathtësi/zotësi/ sjellje	Vlerëson situata dhe burime të informacioneve që kontribuojnë drejt krijimit dhe forcimit të stereotipave dhe paragjytimeve (ekzistuese) për të tjerët	Analizon video/tekst/fotografi dhe i identifikon termet, shprehjet që kontribuojnë drejt forcimit të stereotipave dhe paragjytimeve.
Vlera dhe qëndrime	Angazhohet për respektimin dhe pranimin e të tjerëve dhe vlerave, besimeve dhe sjelljeve të tyre pozitive/përgjithësisht të pranuar	Merr pjesë në aktivitete për promovimin dhe forcimin e integritetit ndërkulturore në mjedisin e tij të drejtpërdrejt.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit në grupe të vogla analizojnë video/tekste/fotografi (të siguruar nga mësimdhënësi) që i përfaqësojnë bashkësitë etnike ose të tjera kulturore në mënyrë stereotipe. Nga nxënësit kërkohet t'i nxjerrin termet, fjalitë, të dhënat, ilustrimet që paraqesin stereotipa. Më pas kërkohet nga nxënësit t'i përpunojnë materialet e dhëna dhe t'i bëjnë të promovojnë respektim të diversiteteve.
- ➔ Nxënësit marrin tekst me temën: "Me kë udhëtojmë me autobus ose me tren" dhe në tekstin do të lexojnë përshkrime të njerëzve që udhëtojnë me trenin. Më pas nxënësit marrin detyrë të përzgjedhin tre persona me të cilët më së shumti do të donin të udhëtojnë dhe tre me të cilët më së paku do të donin të udhëtonin. Në diskutim plenar, secili grup i prezanton konstatimet e tij, duke përfshirë edhe arsytet për përzgjedhjet e tyre të përbashkëta. Ata, gjithashtu, duhet të thonë se në cilat "raste" ka pasur mospajtim më të madh në kuadër të grupit. Diskutimi do të mbështetet në raportet e grupit. Për pyetjen "Cilat stereotipa i shkakton lista e udhëtarëve?", „A janë stereotipat përshkrime të dhëna ose janë në mendjet dhe imagjinatën tonë?".
- ➔ Mësimdhënësi përzgjedhë fotografi nga revistat për njerëz që kanë persona interesantë/të ndryshëm/të famshëm dhe të njëjtat i ngjet në fletë prej letre me hapësirë në pjesën e poshtme të fletës në mënyrë që nxënësit t'i shkruajnë përshtypjet e tyre për ta, sipas përshtypjes së parë nga shikimi i fotografisë ose fotografitë i projekton në ekran. Përsëritet procedura derisa punimet nuk kalojnë te të gjithë nxënësit në rreth dhe të gjithë nuk e shohin secilën fletë. Më pas diskutohet për atë: Çfarë befasi kishte? Përshkruani dhe ndani shembujt kur së pari keni pasur përshtypje krejtësisht të gabuar për dikë? Çfarë zbuloi ky aktivitet për ne vetë?

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron se si stereotipat dhe paragjykimet kontribuojnë për diskriminim të hapur ose të fshehur	Analizon stereotipa më shpesh të pranishëm në përditshmërinë dhe pasojat prej tyre për individë dhe për shoqërinë.
Shkathtësi / zotësi/ sjellje	Analizon arsye për ekzistimin e stereotipave dhe paragjykimeve ndaj pjesëtarëve të kulturave të ndryshme dhe propozon mënyra për t'i tejkaluar ato	Sqaron origjinën e stereotipit në bazë të informacioneve të siguruar relevante dhe propozon mënyra për t'i tejkaluar ato.
Vlera dhe qëndrime	Është i gatshëm t'i pranojë anëtarët e grupit pa stereotipa dhe paragjykimet, në raport me nevojat dhe traditat e tyre kulturore	Nxitë dhe merr pjesë në aktivitete së bashku me pjesëtarë të kulturave tjera dhe sillet ndaj tyre me respekt dhe bashkëpunon me ta.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit në grupe, të formuar sipas gjuhës së mëimit ose karakteristikave të tjera kulturore, zhvillojnë hartë konceptuale për deklaratat, terme konkrete stereotipe, etj. Harta konceptuale zhvillohet sipas instruksioneve të dhëna paraprakisht nga mësimdhënësi. Më pas secili grup prezanton dhe zhvillon diskutim për atë se për terme të njëjta kemi të kuptuarit të ndryshëm. Për shembull: vjedhës, agresiv, të paarsimuar, të varfër, të papastër, etj.
- ➔ Nxënësit të ndarë në grupe të vogla (4-6 nxënës) marrin nga mësimdhënësi kartelë me deklaratë dhe fjalë që paraqet stereotip dhe këtë duhet ta ilustron në grup, ndërsa nxënësit tjerë duhet ta qëllojnë termin ose deklaratën. Më pas zhvillohet diskutim për deklaratat ose termet stereotipa në grupet në mënyrë që të konkludohet se duhet të jemi të vetëdijshëm se stereotipat janë fotografi dhe supozime që shpeshherë kanë pak lidhje me realitetin.
- ➔ Mësimdhënësi lëshon muzikë dhe ata duhet të tentojnë të qëllojnë prej ku rrjedhë. Nëse muzika ka fjalë, grupi duhet të imagjinojë se për çfarë bëhet fjalë. Më pas bisedohet për atë nëse janë të befashuar për origjinën e muzikës. Nëse pjesëmarrësit shprehin se nuk kanë qenë të njoftuar me muzikën, por u ka pëlqyer, pyetini pse? Vallë për shkak se muzika e tillë nuk lëshohet në radio, televizion? Pse nuk lëshohet?

## Barazi dhe barabarësi sociale

(Konkretizim i standardeve kombëtare: VI-A.13; VI-B.3; VI-B.4; VI-B.5)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Identifikon situata (nga libra, filma ose përvojë të ngjashme) kur diskush është i trajtuar në mënyrë të padrejtë për shkak të përkatësisë në grup kulturor	Tregon dhe përshkruan me gojë ose me shkrim situata të diskriminimit kulturor dhe social.
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Reagon ndaj situatave të (pa)drejtësisë sociale në rrethimin e drejt-përdrejt	Vëren situata të padrejtësisë sociale në rrethimin dhe reagon me mosmarrëveshje, dhënie të ndihmës, kërkesë për ndihmë nga të rriturit.
Vlera dhe qëndrime	Konsideron se të gjithë njerëzit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga përkatësia e tyre kulturore	Sqaron me gojë ose me shkrim dhe diskuton në mënyrë të argumentuar të drejtën e respektimit të kulturave të ndryshme.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Secili nxënës merr një fletë prej letrës që duhet ta bëj shuk dhe nga vendi ku është i ulur ta hedhë në shportën për mbeturina që është vendosur para tabelës. Meqë të gjithë nuk kanë mundësinë e njëjtë “për të dhënë kosh” iniciohet diskutimi për atë se çfarë është mundësia korrekte, si të sigurohen mundësi të barabarta për sukses dhe merren shembuj nga jeta reale.
- ➔ Mësimdhënësi gjen histori përkatëse ose film të shkurtër ku dikush nuk është i trajtuar në mënyrë të drejtë për arsye se është i varfër, nga një racë/religjion/kulturë tjetër, nuk njih gjuhën, ka ndonjë handicap trupor. Nxënësit diskutojnë se çfarë nuk është korrekte në trajtimin e tij, si ndjehet, si do të ishin ndjerë ata në vendin e tij, çfarë duhet të bëjnë personazhet tjera në historinë në mënyrë që të përmirësohet padrejtësia.
- ➔ Nxënësit mendojnë për shoqëri pa padrejtësi në të cilën do të donin të jetojnë. Nxënësit shkruajnë në fletë ngjitëse (stiker) dy karakteristika të shoqërisë imagjinare, e më pas i ngjitin në murë ose në tabelë. Më pas duhet të mendojnë për dy gjëra që nuk mundësojnë karakteristikat e shkruara të jenë pjesë e shoqërisë së tyre ideale. Secili nxënës merr tullumbace dhe pe, në mënyrë që t'i lëshojnë tullumbacet në erë, që paraqesin pengesa në krijimin e shoqërisë ideale të ëndrrave. Lutën nxënësit që t'i pëlçasin tullumbacet dhe me këtë t'i mënjanojnë pengesat për shoqëri ideale.
- ➔ Nxënësit marrin pjesë në aktivitete që zbatohen në shkollë për përmirësimin e barazisë sociale (aksione humanitare, aktivitete inkluzive, mbështetje të bashkënxënësve, etj.).

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron se të gjithë njerëzit, pa dalim të karakteristikave kulturore, duhet të jenë të barabartë në realizimin e të drejtave të tyre	Diskutim me shkrim dhe me gojë dhe argumenton pse njerëzit pa marrë parasysh karakteristikat kulturore duhet të kenë të drejta të njëjta në shoqërinë.
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Propozon mënyra të drejta të veprimit në situata në të cilat për shkak të përkatësisë ndaj grupit të caktuar kulturor njerëzit nuk janë të trajtuar në mënyrë të barabartë	Vëren dhe analizon situata të padrejtësisë sociale dhe propozon mënyra të trajtimit të drejtë.
Vlera dhe qëndrime	Angazhohet për trajtim të barabartë/të drejtë të pjesëtarëve të kulturave dhe grupeve tjera sociale	Në situata reale jetësore, prezantime verbale dhe me shkrim, angazhohet për trajtim të barabartë të pjesëtarëve të kulturave dhe grupeve të ndryshme sociale.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Ndani nxënësit në dy grupe. Secili grup duhet nga materiali që e ka në dispozicion të bëjë kukull. Njëri grup ka shumë material të llojlojshëm, tjetri të kufizuar. Pasi t'i përfundojnë dhe ekspozojnë kukullat bisedojnë pse të parat janë bërë më mirë sesa të tjerat dhe si ndikojnë në suksesin resurset që i kemi në jetë. Propozojnë mënyra për ndarje më të drejtë të resurseve, fotografi të ndryshme, pyetje të njëjta, Diagrami i Venit.
- ➔ Gjeni film ose tekst të shkurtër që paraqet padrejtësi sociale. Bisedoni për arsyet, personazhet, qëndrimet e autorit. Ndani nxënësit në grupe të vogla të përpilojnë dhe shkruajnë ose dramatizojnë një situatë ku historia përfundon me epilog më të drejtë.
- ➔ Nxënësit qëndrojnë në rreth, ndërsa njëri prej tyre është vëzhgues dhe është jashtë grupit dhe do të shënojë lidhur me historinë që do ta krijojnë. Nxënësit tjerë do të krijojnë histori. Për këtë aktivitet do të përdorin top. Historinë e fillon mësimdhënësi, për shembull: "Kjo është histori për Antonion, një i ri nga Shkupi" dhe ia hedh topin anëtarit të grupit me çka e fton të vazhdojë historinë me një ose dy fjali nga historia, e më pas t'i pasojë topin dikujt tjetër. Pas 10 ose 12 pasimeve të topit mësimdhënësi e kërkon topin për të thënë: "Antonio e njeh Arbenin, djalë që gjithashtu ka histori" dhe ia pason topin dikujt në rrethin dhe nga nxënësit kërkohet të fillojnë ta rrëfejnë historinë e Arbenit. Historitë e shkruara më pas analizohen lidhur me atë se cilat karakteristika i ka njëri dhe cilat tjetri dhe për atë se duhet të kenë të drejta të barabarta.
- ➔ Nxënësit marrin pjesë në aktivitete që zbatohen në shkollë për përmirësimin e barazisë sociale (aksione humanitare, aktivitete inkluzive, mbështetje të bashkënxënësve, etj.).

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Tregon padrejtësi historike sociale ndaj grupit të caktuar dhe identifikon mënyra se si mund të përmirësohet	Sqaron me gojë ose me shkrim shkaqet dhe pasojat e pabarazisë sociale dhe shprehë mendimet e tij për tema nga drejtësia dhe barazia sociale.
Shkathësi/zotësi/sjellje	Diskuton mënyrat në të cilat individit mund të kontribuojë që të sigurohet shoqëri më e drejtë (përmirësim i (pa)drejtësisë sociale)	Tregon ndjeshmëri për persona të ekspozuar ndaj padrejtësisë sociale dhe pabarazisë, propozon dhe ndërmerri aksione për përmirësimin e situatave
Vlera dhe qëndrime	I kundërvihet padrejtësisë, pabarazisë, paragjyimit dhe/ose diskriminimit për shkak të seksit, gjinisë, përkatësisë etnike, religjioze, etj.	Përmes formave të ndryshme të shprehjes (me gojë, me shkrim, artistike, aktivizëm) promovon drejtësi dhe barazi sociale.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit shikojnë film të shkurtër dokumentar (ose lexojnë tregim të shkurtër) për jetën e dikujt të cilit i është bërë padrejtësi në shoqërinë. Diskutojnë për sjelljen dhe ndjenjat e personazheve, për arsyet për gjendjen e tillë, mundësitë e shoqërisë dhe individëve për ta tejkaluar.
- ➔ Nxënësit vizatojnë hartë mendore në temën drejtësi sociale (çfarë nënkuptojnë me këtë). Nëse ka nevojë mësuesi nxitë ndërlidhje me barazinë dhe drejtësinë, pranimin, përfshirjen, origjinën, ekonominë, etj. Nxënësit diskutojnë se si shteti dhe shoqëria maqedonase të sigurojnë drejtësi sociale, në cilat fusha po, në cilat jo, si mund të kontribuojnë ata tani dhe në të ardhmen.
- ➔ Nxënësit identifikojnë situata nga jeta reale në të cilat ka padrejtësi sociale dhe shkruajnë se si mund të tejkalohet ose si kanë kontribuar ata që të tejkalohet. Mund të publikoni video të shkurtra.
- ➔ Nxënësit përmes bashkësisë së nxënësve zbatojnë aksione në shkollë ose në mjedisin për uljen e pabarazisë sociale dhe për drejtësi më të madhe sociale. Në aksionet mund të animojnë edhe persona me ndikim në mënyrë që t'u ndihmojnë.
- ➔ Nxënësit marrin pjesë në aktivitete që zbatohen në shkollë për përmirësimin e barazisë sociale (aksione humanitare, aktivitete inkluzive, mbështetje e bashkënxënësve, etj.).

## Paqe dhe zgjidhje të qetë të konflikteve

(Konkretizim i standardeve kombëtare: V-A.15; V-B.5)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Identifikon përfitime nga zgjidhja e qetë e konfliktit në situata reale ose të imagjinuara	Sqaron shembull të qasjes drejt konfliktit në mënyrë që të gjejë zgjidhje, në vend se të fitohet me çdo çmim (në dëm të tjetrit).
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Konfliktet me moshatarët i zgjidhë në mënyrë konstruktive	Identifikon dhe praktikon strategji përkatëse për përballje efikase dhe të qetë me konflikt me moshatarët.
Vlera dhe qëndrime	Pranon të kontribuojë në zgjidhjen e qetë të konflikteve	Pranon rolin e ndërmjetësuesit në zgjidhjen e konflikteve reale moshatare.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit në çifte marrin detyra që të bëjnë vizatim sipas shembullit të dhënë me atë që njëri nxënës nga çifti merr detyrë të vizatojë miun, derisa një tjetër të vizatojë njeriun. Në shenjë të mësimdhënësit të fillojnë me vizatim duke përdorur një laps të përbashkët shfaqet situata e tërheqjes së secilit drejt qëllimit të tij. Vijnë diskutimi se si të arrihet zgjidhje që secili nxënës të përfundojë me sukses detyrën e dhënë.
- ➔ Nxënësit në bankat e tyre kanë nga një porosi për paqe të përgatitur nga mësimdhënësi. Nxënësit duhet këto porosi t'ia transmetojnë me fjalë të tyre bashkënxënësit që është pesë hapa më larg se ai, të njëjtën gjë duhet ta përsërisë edhe bashkënxënësi. Kështu veprohet me porositë e nxënësve të njëjtë. Zhvillohet diskutim për ndikimin e qasjes pozitive në zgjidhjen e konfliktit.

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron rolin e individëve dhe organizatave në zgjidhjen konstruktive të konflikteve dhe jetesën e qetë në mjedisin multikulturore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hulumton organizata që kontribuojnë në zhvillimin e vetëdijes për zgjidhje të qetë të konflikteve;</li> <li>• Përmend shembuj të individëve që kanë kontribuar në zgjidhjen e qetë të konfliktit.</li> </ul>
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Menaxhon dhe zgjidhë konflikte në rrethim multikulturore përmes lehtësimit/ndërmjetësimit	Përdorë dhe/ose përmendë teknika për lehtësim gjatë zgjidhjes së konflikteve.
Vlera dhe qëndrime	Promovon jetesë të qetë në rrethim multikulturore	Sqaron situatë konflikti si pjesë përbërëse të jetës së njeriut në përgjithësi dhe në mjedisin multikulturore dhe pëse është e pëlqyeshme që të zgjidhen në mënyrë të qetë.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit shikojnë fotografi të njerëzve të cilët janë në konflikt me të tjerë. Më pas zhvillohet diskutim me pyetje të përgatitura paraprakisht, p.sh. a keni pasur ndonjëherë mospajtim me individ tjetër? Si e zgjidhët këtë mospajtim?
- ➔ Nxënësit të ndarë në grupe duhet të shkruajnë letër për situatë të përjetuar të konfliktit ose situatës që e kanë parë ose dëgjuar, por me këtë rast nuk ka pasur zgjidhje të drejtë ose kurrfarë zgjidhje të situatës së konfliktit. Në letrën duhet të drejtohen për ndihmë në zgjidhjen e situatës së konfliktit, duke ofruar me këtë rast shembuj të tyre për zgjidhje. Letra e shkruar lexohet dhe zgjidhja kërkohet fillimisht në klasë me mësuesin dhe bashkënxënësit. Nëse nuk arrihet, dërgohet letër deri te grupi për lehtësim në shkollë.
- ➔ Nxënësit janë të ndarë në katër grupe dhe marrin nga mësuesi materiale dhe detyra të ndryshme (për shembull, të parët të vizatojnë peizazh të pranverës, të dytët të verës, të tretët të vjeshtës, ndërsa të katërtit të dimrit). Derisa grupet punojnë, mësuesi i inkurajon grupin e parë, të dytë dhe të tretë, por akuzon grupin e katërt për shkak se nuk e kanë bërë atë që ua ka kërkuar. Më pas diskutohet për pozicionin e pabarabartë në të cilin ishte vendosur grupi i katërt.

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron se si dallimet kulturore ndikojnë në shfaqjen e konflikteve	Sqaron për etnocentrizmin si arsye për konflikte në mjedis multikulturor.
Shkathësi/zotësi/ sjellje	Përdorë strategji të pranueshme në zgjidhjen e konflikteve dhe sigurimin e bashkëpunimit interkulturore	Sqaron shembuj kur lehtësimit si strategji për zgjidhjen e konfliktit paraqet bazën për përmirësimin e komunikimit mes pjesëmarrësve në konflikt.
Vlera dhe qëndrime	Pranon përgjegjësi për ndërtimin dhe ruajtjen e paqes në rrethimin multikulturor	Sqaron se si secili mund të kontribuojë për jetesë të qetë në mjedis multikulturor dhe të sillet në përputhje me këtë.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit luajnë role sipas skenarëve të dhënë nga mësuesi (sa grupe – aq skenarë). Pasi të prezantohen shfaqjen e tyre kërkohet nga nxënësit që ta ndryshojnë skenarin në pjesën ku ka diskriminim. Vijnë diskutimi për miratimin e konkluzionit për atë se duhet të ndërmerren aktivitete për përmirësimin e padrejtësive.
- ➔ Nxënësit mendojnë për një rast kur janë ndjerë të diskriminuar ose një situatë kur kanë parë se si dikush tjetër është i diskriminuar. Më pas nxënësit janë të ndarë në grupe dhe ia rrëfejnë situatën e tyre grupit shumë shkurt: si është krijuar, si janë ndier, si janë përgjigjur dhe çfarë ka ndodhur pas incidentit. Nxënësit tjerë nga grupi duhet të japin ide të tyre për atë se çfarë do të kishin bërë në situatën e njëjtë dhe të përpunojnë mënyra të tjera të mundshme të zgjidhjes së situatës së diskriminimit.
- ➔ Nxënësit nxjerrin nga kutia “situatë të diskriminimit” në fletë prej letre. Më pas nxënësit duhet t’i qëllojnë ndjenjat e të involvuarve dhe përmes lojës së roleve të prezantojnë situatën. Më pas, nxënësit tjerë vëzhgues propozojnë zgjidhje të mundshme të situatës.
- ➔ Nxënësit hulumtojnë mënyra të mundshme të përbaljes me situata të të diskriminuarve personalisht ose kur përjetojnë situata ku dikush tjetër është i diskriminuar. Më pas diskutohet në temën: “Mos u bën kalimtar i rastësishëm”.

## Globalizimi

(I lidhur me standardet kombëtare: VI-A.20; VI-A.26; VI-A.28; VI-B.6; VIII-A.8)

### CIKLI I PARË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron diversitete të njerëzve në botë sipas kulturës, përkatësisë kulturore, etnike, racore, gjinore, sipas shprehive, zakoneve, traditave, etj.	Identifikon diversitete mes njerëzve dhe e arsyeton mendimin e tij.
Shkathtësi/zotësi/ sjellje	Tregon interes për të komunikuar me fëmijë të vendeve të tjera	Lexon, shkruan, shikon emisione, filma për njerëz të vendeve të tjera dhe përfshihet në komunikimin me fëmijë të kulturave të tjera.
Vlera dhe qëndrime	Beson se është mirë që njerëzit e vendeve dhe kulturave të ndryshme të komunikojnë	Sqaron përfitime nga njohja dhe kontakti me njerëz të vendeve të ndryshme.

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Mësimdhënësi u tregon fotografi nxënësve dhe ata duhet të thonë nga cili vend është dhe të arsyetojnë mendimin. Më pas ndahen në çifte. Secili shkruan në fletë nga 3 fjali për ndonjë vend që e ka vizituar, për të cilin ka shikuar film, ka lexuar. Shkëmbejnë fletët. Nxënësi tjetër duhet të qëllojë për cilin vend bëhet fjalë dhe të sqarojë pse mendon ashtu. Më pas, para nxënësve tjerë e prezantojnë vendin për të cilin kanë biseduar.

---

- ➔ Nxënësit ndjekin video regjistrim të festivalit folkloristik për fëmijë. Më pas bisedojnë për veshjet kombëtare, vallet, këngët e vendeve të tjera për atë se si jetojnë fëmijët në vende të ndryshme, a ka dhe çfarë ngjashmëri? Mund t'i vizatojnë/fotografojnë veshjet kombëtare.

---

- ➔ Nxënësit lexojnë tekst për fëmijë që janë hasur në situatë të mos e njohin gjuhën e tjetrit. Tregojnë përvojat e tyre të karakterit të ngjashëm (nëse i kanë pasur), si kanë vepruar. Bisedojnë për rëndësinë e njohjes së gjuhëve tjera. Gjejnë fjalë/fraza themelore në gjuhë të ndryshme dhe bëjnë simulime të njoftimit (përshëndetje, prezantim) në gjuhë të ndryshme.

---

- ➔ Nxënësit përfshihen në aktivitete onlajn që shkolla/mësimdhënësi i organizon për bashkëpunim me shkolla nga vendet tjera.

---

## CIKLI I DYTË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron pse disa çështje lokale janë të rëndësishme edhe në nivel global	Paraqet dhe arsyeton me gojë dhe me shkrim se si sjellja në mjedisin lokal ndikon në çështje të rëndësishme për njerëzit më gjerë në botë.
Shkathtësi/zotësi/ sjellje	Hulumton se si jeta e njerëzve në bashkësinë personale është e lidhur me botën më gjerë	Përpilon projekt për lidhshmërinë e njerëzve të bashkësisë lokale me njerëzit e vendeve tjera.
Vlera dhe qëndrime	Pranon se njerëzit janë të lidhur në mënyra të ndryshme dhe se bashkëpunimi ua përmirëson jetën	Përfshihet në aktivitete për bashkëpunim në çështje me rëndësi më të gjerë dhe bindë të tjerët që të bashkëngjiten.



## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secili merr hartë të vendit që planifikojnë ta vizitojnë (vende që me siguri nuk i kanë vizituar). Secili nxënës në mënyrë individuale bën plan për vizitë (si do të udhëtojnë, ku do të akomodohet, çfarë dëshirojnë të shikojë, sa kohë do të qëndrojnë në cilin lokalitet, çfarë do të bëjnë). Më pas në grupin e vogël i prezantojnë planet individuale dhe bëjnë plan për udhëtim të përbashkët me të cilin secili do të jetë i kënaqur. Në fund, gjithë klasa bisedon për sfidat gjatë njohimit me kultura të tjera, udhëtimin në vende të tjera, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshëm.

---

- ➔ Nxënësit tentojnë të hulumtojnë dhe të sqarojnë prej ku është ndonjë pjesë e veshjes së tyre. Ku është prodhuar, prej ku janë lëndët e para, si kanë "udhëtuar". I ndajnë njohuritë dhe diskutojnë për lidhshmërinë ekonomike të njerëzve sot.

---

- ➔ Nxënësit përfshihen në projekte ndërkombëtare dhe/ose iniciativa në të cilat nxënësit merren me çështje globale si të drejtat e njeriut, demokracia, ekologjia, etj.

---

- ➔ Nxënësit u përgjigjen pyetjeve si: Nga cili vend është muzika që e dëgjoni? Ku janë prodhuar aparatet me të cilat dëgjoni? Si dëgjoni muzikë onlajn ose nga bartësit e zërit? Më pas diskutojnë se sa përmes muzikës janë të lidhur me vende të tjera dhe çfarë do të ndodhte nëse nuk do t'i kishin ato mundësi.

## CIKLI I TRETË

Domene:	Rezultate nga nxënia Nxënësi/nxënësja:	Standardet për vlerësimin
Domene dhe të kuptuarit	Sqaron lidhshmërinë mes zhvillimeve (historike, kulturore) në nivel lokal dhe global (në të kaluarën dhe ato aktuale)	Analizon dhe prezanton lidhshmëri të zhvillimeve dhe çështjeve lokale dhe atyre globale.
Shkathtësi/zotësi/sjellje	Analizon karakteristikat dhe sfidat e qytetarisë globale	Përpilon eseje, prezantime për qytetarinë globale.
Vlera dhe qëndrime	Konsideron se angazhimi lokal mund të kontribuojë në ndryshimet globale	Përfshihet dhe inicion iniciativa lokale për kontribut në çështjet globale (ekologji, të drejta, varfëri).

## Shembuj për aktivitete:

- ➔ Nxënësit duhet të imagjinojnë se bota është fshat prej 100 banorëve dhe të shënojnë, p.sh. sa prej tyre kanë mbaruar arsimin fillor, e sa fakultet, sa janë të paarsimuar, sa kanë të ardhura nën 1 dollar në ditë, e sa mbi 100 dollarë, sa kanë tualet në shtëpi, sa kanë të ardhura të rregullta, sa marrin mbrojtje shëndetësore. Më pas mësimdhënësi ua tregon të dhënat (nga statistikat botërore) dhe diskutojnë për probleme globale në botë. E shqyrtojnë Agjendën 2030 të KB-ve. Në grupe të vogla diskutojnë se çfarë do të thotë një qëllim i caktuar për bashkësinë ose shtetin e tyre dhe si mund të kontribuojnë ata tani ose në të ardhmen.
- ➔ Nxënësit në grupe të vogla punojnë në projekt hulumtues për atë se si njerëzit janë ndërlidhur ndonjëherë dhe sot. Secili grup mund të hulumtojë aspekt të ndryshëm (transport, informacione, migrime, tregti, kulturë). Hulumtojnë nga literatura, interneti, vizita në muze, rrëfimet e të rriturve për nevojat, situatat, sfidat. Ky aktivitet afatgjatë mund të përfundojë me libër klasor, prezantim elektronik, ekspozitë, ngjarje multimediatike.
- ➔ Nxënësit në grupe të vogla rrëfejnë dhe diskutojnë për përvojat dhe mendimet personale për migrime, shkollime dhe punë jashtë vendit, njohje të gjuhëve dhe çështje të ngjashme të lidhura me qytetarinë globale.
- ➔ Nxënësit e hulumtojnë çështjen e ndotjes globale. Mbledhin të dhëna për gjendjen në nivel global, në vendin tonë, vendbanimin dhe bëjnë hulumtime për familjen e tyre (nëse ndotin me ngrohje, vozitje të makinës, mbeturina të jo seleksionuara, pesticide, përdorin plastikë në mënyrë të pamatur etj.) dhe përlllogarisin se sa mund të kontribuojnë në zvogëlimin e ndotjes si familje, në nivel të fshatit/qytetit, gjithë shtetit.
- ➔ Nxënësit lexojnë tekste nga mediat, historia, arsimit qytetar lidhur me zhvillimin e kulturave në shtetin tonë dhe në shtete të tjera dhe identifikojnë të dhëna që janë të përbashkëta për më shumë kultura. Zhvillohet diskutim për atë se botën e shikojmë si fushë për garë të kulturave në mbështetjen e ndërsjellë në zhvillim dhe bashkëpunim.

# ZHVILLIM I KOMPETENCAVE INTERKULTURORE

## Sigurimi i interkulturalizmit<sup>15</sup>

Në përputhje me Konceptcionin e arsimit fillor, në mënyrë që të sigurohet mënyrë e qëndrueshme e jetesës së përbashkët në shoqërinë tonë multikulturore/multietnike, arsimi fillor përfshin aktivitete dhe përmbajtje që promovojnë respektim të diversitetit kulturor dhe bashkëveprimit mes nxënësve që janë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike dhe mësojnë në gjuhë të njëjtë ose të ndryshme mësimore.

Interkulturalizmi në arsim sigurohet në mënyra të ndryshme. Njëra mënyrë është përmes përfshirjes së përmbajtjeve multikulturore (verbale, vizuale dhe/ose auditive), që i promovojnë karakteristikat kulturore e të gjitha bashkësive etnike/religjioze që jetojnë në vendin tonë dhe/ose bëjnë të ditur në bashkëveprimin mes pjesëtarëve të këtyre bashkësive. Përmbajtje të këtyra janë të pranishme në programet mësimore për të gjitha lëndët, gjithmonë kur diçka e tillë është e mundshme, që reflektohet detyrimisht edhe në librat shkollorë dhe materialet mësimore për këto lëndë.

Në kuadër të lëndëve zgjedhore ofrohen edhe të tilla, që janë të përkushtuar tërësisht ose pjesërisht në përvetësimin e njohurive për simbolet kulturore/etnike e të gjithëve që jetojnë në RMV, si dhe në theksimin e interesave dhe vlerave të përbashkëta të të gjithë qytetarëve të vendit tonë të cilët janë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike. Po ashtu, mes lëndëve zgjedhore përfshihet edhe lënda Gjuhë shqipe që është e dedikuar për të gjithë nxënësit e interesuar që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, turke, serbe ose boshnjake. Pritet që interesi për këtë lëndë të jetë veçanërisht i theksuar në shkollat fillore që gjenden në komunat me përfaqësim të konsiderueshëm të bashkësisë shqiptare, gjë që nuk përjashton mundësinë që interes për mësimin e gjuhës shqipe të shfaqet edhe në shkollat tjera fillore në mbarë vendin.

Interkulturalizmi forcohet edhe përmes organizimit të aktiviteteve për integrim ndëretnik. Këto janë në fakt aktivitete të përbashkëta mësimore dhe jashtëshkollore me grupe "të përziera" të nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Aktivitetet e këtyra janë shumë të rëndësishme për sigurimin e bashkëveprimit mes nxënësve të cilët ndryshe nuk kanë mundësi për të kontaktuar dhe bashkëpunuar në

---

15 [https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20-%20albanski%20jazik\\_1.pdf](https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20-%20albanski%20jazik_1.pdf)

mënyrë tjetër gjatë arsimit formal. Mundësia për realizimin e aktiviteteve të këtylla është më e madhe në shkollat me dy/tri gjuhë mësimore sesa në shkollat njëgjuhëshe. Në kuadër të shkollave dygjuhëshe/tregjuhëshe zbatohen projekte dhe hulumtime të përbashkëta si pjesë e mësimin nga lëndët e detyrueshme dhe realizohen orë të përbashkëta nga lëndët zgjedhore (për të gjithë ose për një pjesë të madhe të tyre). Njëherësh, aktivitetet jashtëshkollore (si shëtitje/ekskursione, kremtime, punëtori njëditëshe, aksione ekologjike dhe humanitare) në këto shkolla organizohen dhe realizohen si aktivitete të përbashkëta me nxënës nga të gjitha gjuhët e përfaqësuara mësimore.

Në mënyrë që të përmirësohet bashkëveprimi mes nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore, shkollat njëgjuhëshe stimulohen të formojnë partneritet me shkolla në gjuhë tjetër mësimore dhe bashkërisht të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë vizita të ndërsjella ose takime onlajn në të cilat marrin pjesë grupe "të përziera" të nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore. Në këtë mënyrë, sigurohen aktivitete të përbashkëta jashtëshkollore (për shembull, punëtori njëditëshe, shëtitje/ekskursione, kremtime, aksione) që i ndjekin rregullat për udhëheqje bilinguale (me përjashtim edhe trelinguale) dhe bazohen në kriteret për aktivitete të përbashkëta, të përshkruara në Konceptcionin për aktivitete jashtëshkollore.

Interkulturalizmi zhvillohet edhe përmes organizimit të punës së përgjithshme të shkollave dygjuhëshe dhe tregjuhëshe, që krijon kushte për komunikim formal dhe joformal të mësimit dhe nxënësve të bashkësive të ndryshme përmes përfaqësimit të detyrueshëm të të gjitha gjuhëve mësimore në ndërrim të njëjtë, përmes aktiveve të përbashkëta profesionale me mësimit nga të gjitha gjuhët mësimore dhe përmes organeve të përbashkëta në të cilat janë përfshirë prindër nga të gjitha gjuhët mësimore.

Në shkollat dygjuhëshe dhe tregjuhëshe është siguruar trajtim i barabartë i të gjitha gjuhëve të përfaqësuara mësimore që dukshëm u reflektua në përmbajtjen dhe mënyrën e sqarimit e të gjitha përmbajtjeve vizuale dhe tekstuale të theksuara në të gjitha hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë shkollës. Ky parim respektohet si për përmbajtjet me karakter edukativ, ashtu edhe për përmbajtje informative, pavarësisht nga fakti se me cilën bashkësi gjuhësore/kulturore/etnike kanë të bëjnë. Në shkollat njëgjuhëshe veçanërisht u kushtohet kujdes përmbajtjeve vizuale dhe tekstuale të theksuara në hapësirat e përbashkëta që të mos nxisin etnocentrizëm, por përkundrazi, të promovojnë Republikën e Maqedonisë së Veriut si shtet multikulturore/multi-etnik.

Mënyrat e përmendura për sigurimin e interkulturalizmit në arsimin fillor, nga aspekti i këtij dokumenti nënkupton funksionimin e shkollave në frymën e interkulturalizmit dhe orientimit drejt arritjes së standardeve kombëtare që përfshin edhe zhvillimin e nxënësve të kompetencave të nevojshme për interkulturalizëm. Me fjalë të tjera, shtrirja e këtyllë e arsimit fillor siguron bazë të shëndoshë dhe parakusht të nevojshëm për zhvillimin e kompetencave interkulturore të nxënësve.

# METODA TË REKOMANDUARA PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE INTERKULTURORE

## 1 Përvoja

Mënyra më e mira për zhvillimin e kompetencave interkulturore është përmes përvojës së drejtpërdrejt, përmes përjetimit të drejtpërdrejt të diversitetit, të tjetrës. Veçanërisht, përmes “përjetimit të përvojës së huaj”, respektivisht përvetësimit e diturisë për kulturat tjera përmes përjetimit të drejtpërdrejt të asaj se si sillen, ndjejnë dhe mendojnë njerëzit nga perspektiva e tyre.

## 2 Krahasimi

Përmes krahasimit të botëkuptimeve të ndryshme mundësohet të shihen ngjashmëritë dhe dallimet dhe me këtë të gjendet baza e përbashkët për bashkëpunim dhe bashkëjetesë. Krahasimi, gjithashtu, mundëson të tejkalohet frika joracionale nga kultura e panjohur, ndërsa njohja e saj i rrënon barrierat e ndërsjella. Fundja, krahasimi, përfundimisht i thyen stereotipat dhe paragjykimet përmes thyerjes së kuptimeve të ngurtësuara për atë se çfarë është “normale” ose “jonormale”.

## 3 Analizë

Shqyrtimi i thellë, analitik në kulturën personale dhe kulturat e ndryshme, i shpalosë shtresat e fshehura të bindjeve, qëndrimeve dhe praktikave personale dhe të huaja. Kjo mundëson raport kritik ndaj kulturës personale dhe kulturës tjetër dhe sqarim racional të mekanizmave të pavetëdijshme të sjelljes së njeriut. Analiza i shpalosë shtresat rrënjësore të qëndrimeve, mendimeve, sjelljeve të njeriut, si të kushtëzuara në aspektin kulturor.

---

4	<b>Reflektimi</b>	Që të tria, metodat e lartpërmendura, duhet të jenë të shoqëruara me reflektimin, respektivisht të kalojnë nëpër thjerrëzën kritike të vetëreflektimit, me çka do të zhvilloheshin vetëdija dhe të kuptuarit. Reflektimi, „meditimi“ për kulturën „e përjetuar“, „krahësuar“ dhe „analizuar“ mundëson miratimin e gjykimit kritik, të filtruar dhe racional.
5	<b>Veprimi</b>	Në fund, të gjitha metodat e lartpërmendura shpijnë drejt kësaj të fundit – motivim dhe inicim të veprimit. Ato janë baza e qëllimit – aftësia për të ndërmarre veprim „ndaj tjetrit“, „të shtrish dorën“, gatishmëri për të qenë tolerant, bashkëpunues, i ndjeshëm dhe i përgjegjshëm në situata konkrete. Nxitja e veprimit të nxënësit do të thotë përfshirjen e tij në aktivitete, rrethimin dhe situata që i vendosin në test të gjithë hapat paraprak. Ky është zbatim në vepër i integritimit interkulturore.

---

Si rrjedhojë, si qasje më adekuate për nxënie janë: **Nxënia përmes përvojës (Learning by doing)**, **Nxënia përmes bashkëpunimit** dhe **Nxënia përmes projekteve dhe aktiviteteve të projektit**.



**STANDARDE  
PËR ARSIM  
INTERKULTUROR**

në arsimin  
fillor